



12 shkurt 2015, Prizren

### KOMUNIKATË PËR MEDIA

#### Mësimdhënësit udhëtarë po përballen me vështirësi gjatë transportit

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe në muajin shkurt ka hulumtuar çështjen e transportit të mësimdhënësve udhëtarë në Komunën e Prizrenit.

Mësimdhënësit udhëtarë kanë paraqitur një ankesë te monitoruesit e EC Ma Ndryshe, se prej muajit tetor po përballen me vështirësi, pasi që sipas tyre pagesa e transportit për ta nuk po realizohet që prej muajit tetor 2014. Ata kanë sqaruar se operatori i kontraktuar nga Komuna i ka shpërndarë biletat, por se ato nuk po pranohen nga operatorët tjerë transportues, për shkak të mosmarrëveshjeve, meqë operatori që e ka fituar tenderin nuk i ka pranuar mjetet e nevojshme nga Komuna.

Bazuar në këtë ankesë, monitoruesit e EC Ma Ndryshe përmes rrugëve ligjore kanë kërkuar sqarime nga zyrtarët përgjegjës komunal. Në përgjigjen e dhënë nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Prizrenit është konfirmuar se Komuna nuk e ka paguar operatorin e kontraktuar që prej mesit të tetorit të vitit 2014, për shkak të mungesës së mjeteve.

Në përgjigjen e DKA-së thuhet se Komuna përmes Zyrës së Prokurimit ka lidhur një kontratë me një operator ekonomik për transportin e mësimdhënësve udhëtarë të komunës së Prizrenit. "Kontrata ka qenë e lidhur në kohëzgjatje deri në dhjetor të 2014-s. Rishikim të buxhetit për vitin 2014 nuk ka pasur, prandaj mjetet e planifikuara për këtë tender kanë arritur të paguhet deri në gjysmën e muajit tetor 2014. Pjesën e mbetur e kemi paraqitur si borxh të vitit 2014, i cili do të paguhet nga të hyrat e bartura të vitit 2014 në vitin 2015, dhe në momentin e miratimit nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe bartjes së mjeteve nga zyra e buxheteve komunale në kodin e projektit për transportin e mësimdhënësve udhëtarë ne do të bëjmë procedurat e pagesës për operatorin dhe konform kontratës dhe obligimeve të mbetura do ta paguajmë operatorin ekonomik. Pastaj, operatori i dinë obligimet e veta në bazë të regjistrit të mësimdhënësve udhëtarë dhe obligimet e papaguara që ka ndaj tyre", thuhet në përgjigjen e DKA-së.

Sipas të dhënave në kontratën për transportin e mësimdhënësve në komunën e Prizrenit janë 714 mësimdhënës udhëtarë.

Duke i marrë parasysh këto të gjetura, EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Prizrenit që:

- Të rrisë transparencën dhe komunikimin në raport me mësimdhënësit udhëtarë, për çfarëdo shqetësimi apo problemi që paraqitet;
- Të merr masa të menjëhershme për përmirësimin e planifikimit buxhetor, në mënyrë që situata të tilla të mos përsëriten më;

- Të komunikoj afër me të gjitha palët e përfshira në këtë çështje, në mënyrë që të gjenden zgjidhjet e duhura dhe mësimdhënësit të gëzojnë transportin falas, ashtu siç është premtuar nga autoritetet komunale;

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit, të Mamushës dhe të Prishtinës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V) - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*